



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER**

Nr. _____ Prot.

Fier, më ____/ ____/ 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rehabilitimi i Argjinaturës së lumit Vjosa (Segmenti
"Ferras- Ura e Qarrit")”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 5243510-0-
Punime argjinate; 45247111-1 - Punime ndërtimi për kanale ujitëse;**

VLERA E FONDIT LIMIT: 41 045 583.29 (dyzet e një milion e dyzet e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre pikë njezet e nëntë) **lekë pa TVSH** dhe me vlerë totale përfshirë TVSH prej **49 254 699.94** (dyzet e nëntë milion e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e katër) **lekë me TVSH.**

Shënim:

Objekti do të prokurohet, kontraktohet dhe zbatohet me vlerë të plotë brenda grafikut të punimeve, por financimi do të bëhet në 2 (dy) vite buxhetore (2026, 2027), përkatësisht në 2026:

-Gr 17, kap 01 , program 10910 , artikull 231 , me vlerën 17,731,691.98 (shtatëmbëdhjetë milion e shatëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një presje nëntëdhjetë e tetë) lekë me Tvsh, për vitin 2026,

-Gr 00, kap 01 , program AB111 , artikull 231 , kod projekti P424ABO në vlerën 9,850,940 (nëntë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet) lekë me Tvsh, për vitin 2026.

Diferenca do të financohet për vitin 2027, bazuar në shkresën nr.10079/1 prot., datë 04.08.2026 të Drejtorisë Financë Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021e “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti / enti kontraktor, Bashkia Fier, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik“, i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Pika 1 e nenit 83: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.”

Pika 2 e nenit 83: “Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës,”

si dhe në nenin 30 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të çertifikuara të balanceve të 2 (dy) viteve të fundit (2024, 2025), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues

është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 "*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*", i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqerohet me akt-ekspertizën e kryer nga eksperti kontabël.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: "*4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit*"¹. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018, "*Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*".

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë **2 (dy)** viteve të fundit (**2024, 2025**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **38 000 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë që nuk tejkalon vlerën e përlllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me:

- pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: *"3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës."*
- pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:
Pika 1. *"Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare."*
Pika 2/b: *"2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;"*

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorit ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, përkatësisht; Pika 2/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;* Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara më parë gjykon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: *"Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;"*, si dhe në Ligjin nr.29/2023 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave. Njësia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e 2 (dy) viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
 1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 3. Situacionin përfundimtar të objektit;
 4. Aktin e kolaudimit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:
 1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
 2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
 3. Situacionin përfundimtar të objektit;

4. Aktin e kolaudit;
5. Fatura tatimore përfundimtare dhe të deklaruara në organet tatimore.

Ne rastin e paraqitjes së ofertave nga bashkimi i operatoreve, pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”i ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor kërkon kontratë të ngjashme në vlerë 50 % të vlerës së fondit limit, pasi vlera e parashikuar e kontratës është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme, si dhe referuar metodave të përforcimit të objekteve sipas projektit zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Staf kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar për keto punime.

- a)** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë, inxhinierin e mëposhtëm:

1. Inxhinier Ndërtimi

1 (një);

Inxhinieri i sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçencën e operatorit ekonomik ofertues dhe **në listë pagesën e shoqërisë** për të paktën periudhën **Korrik 2026**. Për inxhinierin duhet të paraqitet: Diploma, kontratë individuale pune (*e vlefshme*).

b) Operatori/ët ekonomik ofertues duhet të ketë **në stafin e tij ose me kontratë individuale pune (e vlefshme)** për periudhën e realizimit të kontratës punonjësit sipas profesionit bazuar në zërat e punimeve të preventivit si dhe rendesise se vepres, të paktën si më poshtë:

1. Inxhinier Topograf/Gjeodet pune)

1(një) (në listëpagesë ose me kontratë

2. Teknik Ndërtimi

1(një) (në listëpagesë ose me kontratë pune)

Për punonjësit e sipërcituar duhet të paraqitet: Diploma, Kontratë pune (e vlefshme).

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **në stafin e tij ose me kontratë individuale pune (e vlefshme)** për periudhën e realizimit të kontratës të punësuar 1 (një) punonjës që të disponojë çertifikatë/dëshmi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10 237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr.312, datë 05.05.2010, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Për punonjesin e sipërcituar duhet të paraqitet dëshmi/çertifikatë ose çdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tij, kontratë individuale e punës e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve.

d) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në **specialistë të çertifikuar sipas profesioneve**, të paktën si më poshtë:

- | | |
|------------------------------------|---|
| • Eskavatorist | 3 (tre); (në listëpagesë ose me kontratë pune) |
| • Automakinist | 1 (një); (në listëpagesë ose me kontratë pune) |
| • Buldozerist | 3 (tre); (në listëpagesë ose me kontratë pune) |
| • Shofer me leje drejtimi C | 2 (dy). (në listëpagesë ose me kontratë pune) |

Për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten , dëshmitë / çertifikatat ose çdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve.

Shënim: Për pikat **a), b), c)** dhe **d)** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në shkronjat **a), b), c),** dhe **d)** të pikës **2.3.2**, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

- Për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten dëshmitë / certifikatat ose çdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të paktën periudhen e parashikuar të zbatimit të punimeve.
- Për punonjësit për të cilët kërkohet listë pagesa duhen të jenë të përfshirë **në listë pagesën e muajit Korrik 2026**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, si dhe për shkak të rendesise se veprës në parandalim përmbajtje dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate, si dhe në VKM nr. 216, datë 13.04.2023, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zerat e punimeve”, sipas portalit SIM në e-albania. Vendosja e këtij kriteri për Inxhinieret me licensë është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate, si dhe në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar.

Është kërkuar paraqitja e listëpagesës së muajit **Korrik 2026** për arsye se është muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave. Bazuar në ligjin nr.9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklarimit dhe të pagesës*), operatorët ekonomikë kanë afat të shlyejnë detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të muajit pasardhës.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë fuqi minimale punëtore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, një numër prej jo më pak se 27(njëzet e shtatë) punëtor dhe 1(një) inxhinier Ndërtimi si drejtues Teknik, pra **28 punonjës në listë pagesë për muajin Korrik 2026**, {pa përfshirë në këtë numër specialistët e çertifikuar dhe inxhinierët: Automakinist 1(një), Eskavatorist

3 (tre); Buldozerist 3 (tre); Shofer me leje drejtimi C 2 (dy), Teknik Ndertimi 1 (një) dhe 1 (një) Inxhinier Topograf ose Gjeodet, të cilët pranohen dhe me kontrate pune te vlefshme}

Shënim: Për pikën **2.3.3** më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën **2.3.3**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Korrik 2026**
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për **muajin Korrik 2026**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqerore (pushimet, leje e zakonshme), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit me serial 6A503B44-5AF0-494D-83C0-057B8D9C03CA i datës 23.01.2026, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, rendesise se vepres ne parandalim permbytjesh dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate, si dhe në VKM nr. 216, datë 13.04.2023, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”, sipas portalit SIM në e-albania, si dhe në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar .

2.3.4 Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori ekonomik ofertues, duhet të dëshmojë se dispononë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale tëzbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar”, , lidhja 3 "Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme", kategoritë ndahen sipas lidhja 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi dhe preventivit të punimeve si dhe nga zerat e preventivit te punimeve. Stafi i inxhinierëve të liçensuar bazohet në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve

dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar si dhe nga zerrat e preventivit të punimeve.

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit shoqëria duhet të ketë licencat e mëposhtme:**

NP - 1 A (Punime gjurmimi në tokë);

NP - 9 A (Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime).

- **Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licencat e mëposhtme:**

NS - 18 A (Punime Topogjeodezike)

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në Vendimi e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar lidhja 3 “Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme”, kategoritë ndahen sipas lidhja 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi dhe preventivit të punimeve si dhe nga zerrat e preventivit të punimeve. Staf i inxhinierëve të licensuar bazohet në Vendim nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, i ndryshuar si dhe nga zerrat e preventivit të punimeve.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zerrat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkëngjitur në SPE.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP - 1	<i>Punime gjurmimi në tokë</i>	Analizat për zërat 3.161/2, 3.89/b, 3.110/b, 3.124/3a, 3.164/1a	A

NP – 9	<i>Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime.</i>	Analizat për zërat 3.89/b, 3.161/2, 3.164/1a, 3.110/b, 3.124/3a, 3.211, 3.212/a, 3.331	A
NS - 18	<i>Punime Topogjeodezike</i>	Analizat për zërat 3.89/b, 2.262/4a, 2.130/1a, 3.211, 3.212/a, 3.331	A

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion:

a) Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë dhe **argumentohet në bazë të zërave të preventivit:**

Lista e makinerive për objektin: “Rehabilitimi i Argjinaturës së lumit Vjosa (Segmenti "Ferras- Ura e Qarrit")”					
Nr.	Emërtimi i Makinerisë dhe Pajisjes	Sasia	Manovrator /Shofer	Shënime	Statusi
1	Rul (kompresor) me vibrim	2	Buldozerist	Zëri i preventivit me analizë 3.212/a, 3.211, 3.164/1a	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
2	Ekskavator 0.25 m3	1	Ekskavatorist	Zëri i preventivit me analizë 3.89/b, 3.161/2	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga

					legjislacioni në fuqi
3	Ekskavator 1.0 m3	1	Ekskavatorist	Zëri i preventivit me analizë 3.110/b, 3.124/3a	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
4	Ekskavator 2.0 m3	1	Ekskavatorist	Zëri i preventivit me analizë 3.164/1a	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
5	Grejder	1	Buldozerist	Zëri i preventivit me analizë 3.211, 3.212/a	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
6	Autobot	1	Automakinist	Zëri i preventivit me analizë 3.164/1a, 3.212/a	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
7	Auto vetshkarkuese me kapacitet mbajtës max. 12 m3 sipas specifikimeve teknike faqja fundit për mos dëmtim të argjinaturës	2	Shofer me leje drejtimi C	Zëri i preventivit me analizë 3.211, 3.212/a, An.1, 3.124/3a	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
Shënim: Emërtimi i manovratorve është bazuar në nenin 8 të Urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për pregatitjen teorike-					

praktike të kandidateve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë , si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit " kurse makinerit janë nxjerr bazuar në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”, sipas portalit SIM në e-albania dhe preventivi i punimeve.

b) Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronësi ose me qera ose sipas legjislacionit në fuqi), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si me poshtë (*sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8*):

- Kokore, minimumi 39 copë.
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 copë.
- Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 2 copë.
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 4 copë.

Shënim: Për pikën **2.3.5 (a dhe b)** si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën **2.3.5 (a dhe b)**, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

- a)** Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
- b)** Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c)** Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- d)** Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij / tyre.
- e)** Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- f)** Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me Leje të Transportit të Mallrave (të vlefshme), lëshuar nga organet kompetente në emër të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu, kërkesat për disponimin ose mundësinë e sigurt të disponimit të mjeteve apo kapaciteteve teknike të kërkuara në këtë kërkesë për kualifikim, bazohet edhe në nevojën për mundësinë e sigurtë të disponimit të mjeteve që AK kërkon nga OE, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikime të nevojshme teknike, kapacitetet organizative, makineritë, pajisje të aseteve të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, duke demonstruar kapacitet teknik si për mjetet që do të angazhohen në zbatimin e kontratës, ashtu edhe për kapacitet teknike që lidhen me gadishmerinë për plotësimin e tyre në rrethana të caktuara, duke pasur si synim zbatimin në kohë dhe në cilësi të kontratës objekt prokurimi. Përlllogaritja e makinerive është bërë bazuar në - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”, sipas portalit SIM në e-albania, bazuar në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë me ligjin nr 7961 dt. 12.07.1995 i ndryshuar me ligjin nr. 9125 datë 29.07.2003 si dhe me ligjin 10053 dt. 29.12.2008, bazuar në preventivin me serial 6A503B44-5AF0-494D-83C0-057B8D9C03CA i datës 23.01.2026 dhe grafikun e punimeve. Emërtimi i manovratorve është bazuar në nenin 8 të Urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike- praktike të kandidateve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë , si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit " kurse makinerit janë nxjerr bazuar në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”, sipas portalit SIM në e-albania dhe preventivi i punimeve dhe specifikimeve teknike

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. (pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës dhe janë dërguar me shkresën me nr. 10037 prot., datë 04.08.2026, me lëndë “Dergim dokumentacioni”, nga Drejtoria e Hartimit të Projekteve dhe Kontrollit të Punëve Publik, bashkëngjitur DST në SPE.

Kriteret e vecanta të kualifikimit që lidhen me kapacitetin teknik të fushës së ndërtimit janë hartuar nga specialisti i fushës pjesë e njesisë së prokurimit, duke u bazuar në projektin, preventivin dhe grafikun e punimeve të objektit.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Referimet ku në specifikime/relacion teknik, preventiv, dokumenta bashkëlidhur DST në SPE mund të jenë përmendur si referencë emri i ndonjë marke/ produkte / origjinë, apo emri të vecantë, patentë, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik , shoqërohen me fjalën **“ose ekuivalente”** (standartet që janë sot në fuqi në Shqipëri (KTP – SSH/EN/ISO) dhe për elemente special që nuk parashikohen në këto standarte duhet ti referohemi Euro norms (EN), dhe Eurostandarteve).

Njësia e prokurimit: